



Npi – 01/224 datë: 29.09.2020

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.11 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/149 të datës: 31.05.2019, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më: 29.09.2020 është nxjerrë ky:

**E K S T R A K T**  
**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË -VII- TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES**  
E mbajtur më: 29.09.2020, e (martë) në ora 10.<sup>00</sup> h. në sallën e Kuvendit Nr.1

Në mbledhje kanë marrë pjesë: znj.Medina Brahaj, z.Perparim Ramusa, z.Shefki Dauti, z.Herolind Selmani, z.Reshat Mujota, znj.Arbresha Syla, z.Milot Deliu, znj.Fatmire Ferati, z.Naim Zejna, z.Skender Hyseni, znj.Zarife Rexhaj, znj.Valentina Halili-Ferati, z.Ruzhdi Jashari, z.Besnik Seferi, znj.Marigona Pajaziti, z.Fehmi Hysenaj, znj.Adelina Beqaj, z.Isak Muslija, znj.Diartha Vishesella, z.Muhamet Ademaj, dhe z.Rexhep Gashi.

Përveç anëtarëve të Kuvendit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Kryetari, z.Naim Ismajli; Drejtorët: znj.Shqipe Rexhaj, z.Lumni Amrushu; Zyrtarja Kryesore Financiare znj.Kimete Ukaj; Zyrtari për barazi Gjinore z.Reshat Gashi; Zyrtari Ligjor, z.Lulzim Muharremi; Nga OJQ "YAHR" z.Bekim Krasniqi; Nga OJQ "Vizionida" z.Lulzim Vishesella.

Mbledhjen e hapi Kryesuesja e Kuvendit znj.Medina Brahaj, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit Konstattoj, Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar mbledhjen. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

**REND DITE**

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 31.08.2020,
2. Pyetje-Përgjigje,
3. Ridestnimi i Rezervës Buxhetore Komunale,
4. Prezantimi i Planit Buxhetor Komunal për periudhën 2021-2023,
5. Raport Periodik për zbatimin e rekomandimeve nga raporti i ZKA-së,
6. Informatë nga DKA për përgatitjet e fillimit të Vitit të Ri Shkollor,
7. Shqyrtimi i Kërkesave

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Hapi diskutimin për rendin e ditës.

**z.Fehmi Hysenaj;** Përshëndetje, mendoj se është mirë që Kryesuesja fillimisht me kërkuar falje për vonesën në mbledhje prej 19 minutave.

Pastaj unë kam një kërkesë që duhet të ndryshohet pika 6.2 e rregullores së punës së Kuvendit, që ka të bëjë me aprovimin e rendit të ditës, sepse kështu si është vërtetë nuk ka logjikë. Prandaj unë po

propozoj që të fillojmë procedurën e ndryshimit të kësaj rregullore. Kërkesa ime është që para pikës 7 të rendit të ditës propozoj që të futet si pikë shtesë edhe pika “Anulimi i vendimit Npi-01/178 për ta futur në Hipotekë pronën Komunale e dhënë në shfrytëzim firmës 'Doni Fruits'.

**z.Shefki Dauti;** Përshëndetje, unë jam që të vazhdohet me këtë rend dite.

**z.Ruzhdi Jashari;** Përshëndetje, një vërejtje për Kryesuesen e Kuvendit për vonesën në fillimin e mbledhjes. Kemi ndërhyrje të ekzekutivit në punën e Kuvendit. Pika e rregullores që ka të bëjë me miratimin e rendit të ditës duhet që të ndryshohet. Kështu që unë e propozoj si pikë shtesë që të futet në këtë mbledhje Ndryshimi i rregullores së punës së Kuvendit.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Ju pra vetë e keni aprovuar këtë rregullore të punës së Kuvendit.

**z.Shefki Dauti;** Nëse gjatë punës së Kuvendit ka shkelje Ligjore, ne e kemi edhe një mekanizëm në MAPL-ë ja bën një shkresë dhe le ta kthen ajo në rishqyrtim.

**z.Fehmi Hysenaj;** Unë personalisht e kam deponuar një ankesë në MAPL-ë për sa i përket Vendimit Npi-01/178 për ta futur në Hipotekë pronën Komunale e dhënë në shfrytëzim firmës 'Doni Fruits'. Kështu që unë mendoj se veç çka bëhet diçka pozitive nga ky Kuvend nëse anulohet ky vendim.

**z.Naim Zejna;** Edhe unë i bashkëngjitëm, propozimit për ndryshimin e rregullores. Unë dua që vonesa të shënohet në procesverbal që është bërë për shkak të konsultimeve të grupit të deputetëve të PDK-së. Sa i përket vendimit për Hipotekë të firmës “Doni Fruits” nëse në kontratë shkruan se nuk mund të epet në Hipotekë, atëherë edhe unë jam për ta futur në rendin e ditës.

**z.Perparim Ramusa;** Përshëndetje, ne pajtohemi me propozimin e rendit të ditës. Sigurisht që kanë të drejtë me propozuar pika shtesë të rendit të ditës por në fund vendos Kuvendi nëse do të futen në rendin e ditës ose jo.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Konstatoi Kuorumin, prej 20 anëtarëve prezent në mbledhje.

**\* Kuvendi i Komunës, me 12 vota “Për” me 6 vota “Kundër” dhe me 2 vota “Abstenim” aprovoi Rendin e Ditës.**

#### Pika 1

##### Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 31.08.2020

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**z.Fehmi Hysenaj;** Te pika raporti financiar kam thënë: “ Shpenzimet për çështjen e transportit për ditët e Masakrës së Reçakut” ashtu psh. si është e shkruar nuk është mirë.

**znj.Adelina Beqaj;** Përshëndetje, (mendova se po diskutojmë për pikën Pyetje-Përgjigje)

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Konstatoi Kuorumin, prej 20 anëtarëve prezent në mbledhje.

**\* Kuvendi Komunës së Shtimes, unanimisht aprovoi, Ekstrakt Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 31.08.2020, me vërejtjen e Fehmi Hysenaj.**

#### Pika 2

##### Pyetje-Përgjigje

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**Adelina Beqaj;** Në pyetjen time që e kam adresuar te drejtori i DZHE-së Fitim Hoxha, unë nuk po e kuptoj a me është drejtuar mua me përgjigje a kujt i është drejtuar. Edhe po me intereson me dite nga DKA-ja pse nuk figuron emri i universitetit te lista e bursave per student?

**Ruxhdi Jashari;** Në mbledhjet e kaluara unë kam pyetur, pse nuk po zbatohen vendimet e Kuvendit nga Ekzekutivi, në këtë pyetje nuk më janë përgjigjur fare. Po ashtu kam bërë pyetje për DSHMS-në, dhe kam kërkuar listën për pagesat e qirave për kategori të caktuara që janë më nevojtare siç janë

pensionistët, pastaj shoqatat e organizatat pastaj familjet me raste sociale, dhe nuk e kam marrë. Unë po kërkoj që të përsëriten pyetjet.

**Fehmi Hysenaj;** Unë po jap rregullisht vërejtje se ne nuk po marrim përgjigje në pyetjet tona. Pse nuk po zbatohet Udhëzimi Administrativ Nr.04/2018 neni 4, paragrafi 3-4 që udhëzon të jene në ueb-faqen e Kuvendit të gjitha materialet e Kuvendit. Çka ka bërë ekzekutivi i Komunës për ta ngrit çështjen në nivelin qendrorë për sa i përket rrugës transit kah Lagja e Pajtimit, sepse siç dihet gjendja e asaj rruge është e pa kalueshme nga fshati Davidovc deri lartë te Pishat? Nga DKA-ja kërkoj informata të detajuara për çështjen e bursave për studentë?

**Muhamet Ademaj;** Përshëndetje, unë kam pyetje për DSHP-në, pse nuk po pengohet hedhja e mbeturinave në hapësirat publike sidomos në periferi të qytetit? Dhe kam një pyetje tjetër për DZHE-në, kur do të vendosen bizneset në Zonën Ekonomike që e kemi shpallur në afërsi të fshatit Gllavicë?

**z.Skender Hyseni;** Është mirë që ka vazhduar puna në rregullimin e rrugëve të arave, por pyetja ime është se në fshatin Muzeqinë ekziston një kanal bukur i thellë a do të vendosen gypa për të bërë të mundshëm kalimin e bujqve në arat e tyre? Sa i përket hedhjes së mbeturinave ju kisha lutë që me ndërmarrë veprime për me i hekë mbeturinat dhe me e vendosë një shenjë informimi për mos-hedhjen e mbeturinave në periferi të fshatit Muzeqinë?

**z.Reshat Mujota;** Përshëndetje, unë realisht kam një pyetje për Komisionin, kërkoj që të na jep një sqarim se si ka shkuar procedura e ndarjes së Bursave për studentë?

**z.Shefki Dauti;** Përshëndetje, fshati Belinc ka ankesa të mëdha lidhur me çështjen e ndaljes së energjisë elektrike. ne i dimë raportet e Komunës me KEDS, por aty faktikisht po ndalet rryma pa kurrfarë paralajmërimi. Ne duhet ta dimë së paku se ku qëndron problemi?

**z.Rexhep Gashi;** Përshëndetje, ne çdo herë bëjmë pyetje, por asnjëherë nuk marrim përgjigje të plotë. Këtu është një neglizhencë e Ekzekutivit. Çka ka ndodhur me gurthyesin të asfaltimit të rrugës së Muzeqinës, ku ende nuk është bërë pranimi teknik. Pse nuk është bërë pranimi teknik që nga viti 2018, dhe far masa janë marrë ndaj operatorit ekonomik?

**z.Besnik Seferi;** Përshëndetje, kam një pyetje për Kryesuesen, se pse nuk po transmetohen te qytetari mbledhjet e Kuvendit? Pyetje për DSHP-në, kur do të bëhet një zgjidhje për sa i përket vend-pritjes së taksistëve për Ferizaj, po bëhet fjalë vetëm për një vend te parku "Ahmet Shtimja"? Çfarë është duke ndodhur me mirëmbajtjen e parqeve nëpër fshatra, ku janë bërë investime bukur të mëdha, kur do të inspektohen ato? Pse nuk rregullohen shenjat e komunikacionit, kur shumë prej tyre janë rrëzuar e disa edhe mungojnë?

**z.Naim Zejna;** Unë kamë mospajtim me përgjigjen e DSHP-s në të cilën është dhënë një përgjigje jo profesionale, me të cilën unë nuk pajtohem. Po ashtu nuk pajtohem edhe me çështjen e furnizimit me ujë e qe po mungon vazhdimisht. Pyetjen për DPUKGJ-ne qe ka te bej me barrierat, ne e kemi pas një kërkesë më herët lidhur me barrierat, por po pyes pse nuk është realizua. Pyetje për DSHP-në pse nuk po vendosen pasqyrat e komunikacionit qe janë premtuar se do të vendosen? A është funksional komisioni për ridestinimin e banesave Komunale, dhe pse nuk kemi një raport?

**znj.Valentina Halili-Ferati;** Përshëndetje unë kam një pyetje për ekzekutivin e Komunës, se a është nën mbrojtje të veçantë, vendndodhja e Masakrës së Reçakut më 15 Janar 1999?

**znj.Zarife Rexhaj,** Përshëndetje është një deklaratë e prindërve të nxënësve se nëse ka fëmija simptome me KOVID19 atëherë edhe prindërit duhet të deklarohen se a përjashtohet fëmija nga procesi mësimor apo jo?

### Pika 3

#### Ridestnimi i Rezervës Buxhetore Komunale

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Kimete Ukaj.

**znj.Kimete Ukaj, zyrtare kryesore financiare;** Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, prezantoi këtë pikë sipas tabelave. Dokumentin në e kemi përgatitur në formë të shkruar dhe ju e keni marrë me kohë. Unë i mirëpres pyetjet e juaja, (shih dokumentin).

**z.Naim Zejna;** Faleminderit për prezantimin e kësaj pike. Unë po e shohë që shuma të kodit mallra dhe shërbime është rritur. Te KRM "Pastërtia" edhe ne kemi dakord që të rritet shuma. Kërkoj që kjo të jetë e shkruar në procesverbal.

**z.Rexhep Gashi;** Ridestininimin nuk mundë ta lëshoni kurdo por vetëm në mënyrën e parapare me Ligj. Edhe unë jam për ti ndihmuar KRM "Pastërtisë". Siç e dini të bizneset e kemi punën keq për shkak të gjendjes së pandemisë, dhe nuk u kemi dhënë përkrahje, kështu që unë jam që bizneset të ndihmohen.

**z.Perparim Ramusa;** Në emër të subjektit politik të PDK-së, ne edhe në KPF-ë e kemi përkrahur ridestininimin e rezervës buxhetore, kështu që edhe tani e përkrahim rekomandimin e KPF-së.

**z.Ruzhdi Jashari;** Ne në KPF-ë i kemi bërë disa vërejtje. Rezerva të planifikuara janë 67.000€. Ju kemi planifikuar që 28.000€ të shkojnë te firma "Kadolli" për përfundimin e shkollës në Carralevë, ku sa e di ne kemi bërë një herë një ndarje të mjeteve financiare për këtë shkollë, tani nuk e di pse duhet me nda prapë mjete për këtë shkollë. Le të merret prokuroria me këtë çështje. Këtu nuk kemi kodifikim të projekteve por kemi duplikim të dhënies së mjeteve financiare pa kriter. Krejt këto po sillen rreth Klubit të Biznesit në Shtime ku aty është Rexha, Kadolli e disa tjerë.

**z.Fehmi Hysenaj;** Nuk e kemi përfillur propozimin tonë për ndarjen e 100€ për një fëmijë të lindur.

**z.Muhamet Ademaj;** Edhe unë jam që me mjete financiare ti ndihmojmë, KRM "Pastërtisë", e pjesa tjetër le të shkon te shkolla e Mesme Profesionale për kabinete për nxënës.

**z.Skender Hyseni;** E falënderoj Kimeten për prezantimin e kësaj pike. Unë po pyes nëse ka mundësi që nga këto mjete të rezervës një pjesë e tyre të ndahet edhe për bujqësi.

**znj.Kimete Ukaj, zyrtare kryesore financiare;** Sqaroi për pyetjet që janë bërë. Shkolla e Carralevës ka qenë e planifikuar për ndërtim me participim, por Ministria këtë vit nuk e ka futur për financim. Nuk ka asnjëherë që unë kame sjell në Kuvend një kërkesë për ndarje të mjeteve financiare për shkollën e Carralevës. Në vazhdim zyrtarja sqaroi me shifra, kodet që janë paraparë për ndarje financiare.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Konstatoi Kuorumin, prej 18 anëtarëve prezent në mbledhje\* **Kuvendi i Komunës, me 15 vota "Për" me 0 vota "Kundër" dhe me 3 vota "Abstenim" aprovoi Ridestininimin e Rezervës Buxhetore Komonale.**

#### Pika 4

##### Prezantimi i Planit Buxhetor Komunal për periudhën 2021-2023

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** E njoftoj Kuvendin me rekomandimet e KPF-se si dhe me takimet e organizuara të Kryetarit me OJQ-te, bizneset, subjektet politike, për sa i përket Planit Buxhetor Komunal për vitin 2021-2023. Diskutimi publik është organizuar nga Zyra e Kryetarit së bashku me OSBE-në me datën 28.09.2020. Në këto takime kanë marr pjesë Kryetarët e Fshatrave.

**znj.Kimete Ukaj, zyrtare kryesore financiare;** Tani ne e dimë që jemi në kohën e pandemisë dhe procedura për Planin Buxhetor është shkurtuar. Këtë Plan ne e kemi hartuar duke pas për bazë Kornizën Afatmesme Buxhetore, bazuar edhe në Ligjin për menaxhimin e financave publike. Jemi munduar të marrim propozimet nga të gjitha organizatat buxhetore. Materialin e kemi marrë, edhe pse pak me vonesë për shkak se edhe ne ashtu e kemi pranuar nga Ministria e Financave. Në vazhdim Kimete Ukaj i lexoi shumat sipas tabelave dhe kodeve ekonomike që janë propozuar. E kemi zvogëluar shumë të Administrata për ta funksionalizuar Çerdhen e re të fëmijëve ku i kemi parapa 20.000€, kështu që është zvogëluar granti i përgjithshëm. Në fund zyrtarja i ftoi Delegatët që ta miratojnë Planin Buxhetor 2021-2023.

**z.Adelina Beqaj;** Faleminderit për prezantimin e kësaj pike, mua po më intereson me dite se a ekziston mundësia që ky buxhet të shkon në rishikim, sepse ka qenë afati i shkurtër.

**znj.Kimete Ukaj, zyrtare kryesore financiare;** Sqaroj në pyetjen e Adelina Beqaj, lidhur me afatet se si Plani ka ardhur nga Ministria, nëse kjo pastaj e konstaton se nuk është ne përputhje me ligjin atëherë shkon ne rishikim.

**znj.Adelina Beqaj;** Unë po pyes, nëse e miratojmë sot, Planin Buxhetor a ekziston mundësia e ndryshimit të tije.

**znj.Kimete Ukaj, zyrtare kryesore financiare;** Jo

**z.Fehmi Hysenaj;** Faleminderit për materialin që e kemi marrë me kohë. Është një çështje që nuk po zbatohet sipas Udhëzimit Administrativ ( U.A.) për minimumin e kritereve që duhet zbatuar për organizimin e një tubimi publik, pse nuk ka ndodhur kjo? Te Klauzola e investimeve po dua me pas një sqarim shtesë. Propozoj që ZKF-ja le ti heq mjetet financiare aty ku ka mundësi me qëllim që me ua nda familjeve për lindjen e fëmiut në shumën prej 200 ose 300€ të cilën edhe mundë ta diskutojmë.

**z.Besnik Seferi;** Faleminderit për prezantimin për këtë pikë. Po mundohem të sqaroj pse duhet të subvencionohen me nga 100€ çdo lindje të fëmiut. Unë mendoj se të gjithë jemi të vetëdijshëm për gjendjen e rëndë sociale të banorëve të komunës sonë. Ne propozojmë që kjo ndihmë të jetë e dedikuar për nënat që lindin fëmijë, në shumën nga 100-150€, mendoj se do tu ndihmoj sadopak këtyre familjeve, po ashtu mendoj se ka edhe bazë ligjore dhe kushtetuese. Me këtë vendim do të tregonim një përkujdesje për fëmijët e porsalindur të komunës sonë. Unë nuk mendoj se ky është një propozim politik, por është një ndihmë për familjet tona.

**z.Fehmi Hysenaj;** Le të tregoj Besniku se ku e kam dallashitur propozimin, ndërsa sa i përket vlerës përkatësisht shumë në mundë ta diskutojmë.

**z.Ruzhdi Jashari;** Unë jam në mbështetje të plotë të propozimeve të Besnikut dhe Fehmiut. Me të njëjtin format ne mundë të marrim vendim për lindjen e fëmijës sikurse që kemi marrë vendim për rastet e vdekjes. Por shumë se sa do të ndahen mundë ta diskutojmë. Unë kam edhe një propozim tjetër të dytë që secilit prind që është i pa punë të fëmiut të porsalindur me ja nda nga 20€, këto mjete me i marrë nga shpenzimet.

**z.Besnik Seferi;** Sa i përket pyetjes se ku do ti marrim këto pare, unë mendoj se këto lehtë mundë të gjinden, sepse shumë më e rëndësishme është ekzistenca e familjeve, se sa asfalti.

**znj.Arbresha Syla;** Përshëndetje, ndihma për qytetarët është e mirë, por unë mendoj se është problem bukur i madh me bërë këtu politik që realisht kjo çështje i takon nivelit qendror. Unë mendoj se neve na nevojitet ndërtimi i një strategjie ku fillimisht duhet me i krijuar kushtet per lindjen e fëmiut e tek pastaj me shikuar aspektin e subvencionimit. Këtu duhet të shikohet dhe analizohet mire aspekti i natalitetit. Nënat mundë ti ndihmojmë në forma të ndryshme siç është pushimi i lehonisë etj. e jo me propozime populiste që të ndahet një shumë e parave. Problemi tjetër është se nuk është analizuar fare ku me i marrë mjetet, kjo po thuhet vetëm sa për ta thënë u gjetën apo nuk u gjetën paret.

**z.Reshat Mujota;** Përshëndetje, mua po më pëlqen propozimi por këta të opozitës mes vete po merren me politikë. E para që duhet me ditë është se ku po i marrin mjetet financiare, e pastaj me marrë vendim.

**z.Muhamet Ademaj;** E falënderoj, Kimete Ukaj për prezantimin e kësaj pike. Plani Buxhetor duhet shikuar ne aspektin e mundësive. Mendoj se është e rëndësishme që të ketë një ndarje gjithëpërfshirëse. Unë e përkrahu këtë plan Buxhetor.

**z.Perparim Ramusa;** E përgëzoj ZKF-ë për prezantimin e Planit Buxhetor 2021-2023. Asnjë fshatë ose bashkësi nuk ka mbetur pa u përfshi në kuadër të projekteve. Unë jam që ky Plan Buxhetor të votohet kështu siç është propozuar. Sa i përket propozimit të Fehmiut dhe Besnikut unë jam

plotësisht në dakord me ta dhe duhet të përkrahen, por vetëm nëse i gjejmë mjetet financiare. Unë po kërkoj që ta kemi një propozim konkret me shifra, e tek pastaj do ta shoh a mund ta përkrahim.

**z.Shefki Dauti;** Po bëhet Buxheti i 8 që do ta votoj. Një gjë duhet ta dimë se Buxhetin nuk mundemi me ndryshuar brenda një ore. Kemi pas disa debate publike, që për fat të keq nuk po marrin pjesë numër i mjaftueshëm i qytetarëve. Në debat duhet me i dhënë propozimet e pastaj ato duhet të përpunohen, e jo brenda 15 minutave hajde ti marrim nja 100.000€ qaty, kjo nuk shkon kështu, propozimet kemi pas mundësi me i dërguar edhe me E-mail. Sot ne këtu mundë të jemi vetëm votues “Për” ose “Kundër”, nuk është e drejt që ne sot këtu të bëjmë politik, por duhet të jemi praktik, unë jam “Për”.

**z.Fehmi Hysenaj;** Nuk është kjo hera e parë që deputetet kanë mundësi me i dhënë propozimet e tyre. Unë për vete nuk e kam problem, le të jetë edhe propozim i PDK-së fare nuk e kam problem por unë po them që 100.000€ ti ndajmë për këtë kategori dmth. për fëmijët e porsalindur.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Unë mendoj se propozimi është i mirë, por ZKF-ja duhet të na tregoj se sa është mundësia financiare e realizimit.

**z.Besnik Seferi;** Nëse po bëhet politik atëherë po e bënë PDK-ja, sepse paskan vendosur për propozim buxhetin, sepse sa i përket pyetjes ku me i marrë mjetet e sqaroi Fehmi Hysenaj. Edhe unë jam dakord që të merren te Mallrat dhe Shërbimet, fjala është për 100.000€.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Unë ju kam ftuar me SMS në takimin që e kemi mbajtur për Buxhetin, dhe nuk kam pranuar as një përgjigje për mos prezencë. Është bërë praktik që ditën e fundit faktikisht në mbledhjen e fundit të vërshojnë propozimet, ne duhet të kemi edhe përgjegjësi morale sepse edhe unë jam për ti mbështetur fëmijët e porsalindur por jo kështu në ditën e fundit, sepse kjo e donë një analizë financiare më të thellë.

**z.Naim Zejna;** U diskutua shumë për këtë propozim. Plani Buxhetor nuk është definitiv. Shtesat për fëmijë duhet të jenë çështje e nivelit qendror. Ka pas fërkime për 10€ për nënat e nuk janë pajtuar në Kuvendin e Kosovës. Unë mendoj se për vitin tjetër mundemi me miratuar, por duhet ta favorizojmë si kategori. Meqenëse se nesër duhet me doriu Buxhetin në ministri unë nuk pajtohem për shkak të situatës që e kemi për me i bërë këto ndryshime sot. Te investimet kapitale grupit parlamentar të LDK-së ju kanë pranuar të gjitha propozimet. Unë nuk i kam faj askujt që nuk bashkëpunon e tash vjen këtu për me krijuar divergjenca. (në vazhdim i përmend të gjitha projektet e grupi parlamentar të LDK-së që janë futur në listën e projekteve kapitale).

**z. Reshat Mujota;** LDK-ja e paska bërë Buxhetin krejt, ndërkaq që ne po akuzohemi se nuk po e bëjmë Buxhetin mirë.

**z.Naim Zejna;** Replik, (kanë dialoguar me Reshat Mujotën).

**z. Reshat Mujota;** Replikë, Ne e kemi votuar KAB-in, dje kërkesat pakë a shumë janë të njëjtat, unë nuk po e akuzoj LDK-në por po e falënderoj.

**znj.Fatmire Ferati;** Përshëndetje edhe unë e përkrahu propozimin për fëmijët e porsalindur, mirëpo kjo duhet të bëhet në bazë të statistikave dhe trendit të lindjeve. Pjesën tjetër po e qojmë ne kategorinë e subvencioneve mirëpo aty duhet me ditë se e kemi të vendosur një tavan financiarë. pastaj duhet ta dimë se a mundemi me e tejkualuar këtë tavan apo duhet me e ndryshuar për subvencionet.

**z.Rexhep Gashi;** Këtu po flitet për politika, e neve politika na ka sjellë deri këtu. Ky vit është më i veçantë nga vitet tjera për shkak të pandemisë. I kemi dhënë mjete financiare OJQ-ve, individëve pa kurrfarë kriteri. Kemi kategori siç janë pensionistët pastaj të verbrit, e qe shumica e asamblistëve nuk e dinë që ka shoqatë të verbërve, për të cilët ne nuk po mendojmë fare. Po bëhen projekte për asfaltin e nuk i kemi te specifikuara lagjet ku do te shtrohet asfalti. Edhe unë e përkrahi iniciativën e parafolëseve për fëmijët e porsalindur. Para se të vendosim për Buxhetin unë propozoj një pauzë konsultative prej 10 minutave.

**z.Ruzhdi Jashari;** Propozimet janë me vend, kur kemi marrë vendim për vdekjet nuk kemi pyetur a është i pasur a është i varfër kështu që le të shkojë edhe ky si vendim i njëjtë, ndërsa sa i përket sigurimit të mjeteve unë besoj se ZKF-ja mundë ti gjen.

**znj.Kimete Ukaj, zyrtare kryesore financiare;** Sa i përket propozimit për fëmijët e porsalindur unë mendoj se e meritonjë jo vetëm 100€ por edhe 200€ e më shumë. Kufijtë Buxhetor nuk i caktoj unë por Ministria e Financave mbi bazën e disa kritereve, ne duhet të sillemi brenda këtyre kufijve Buxhetor. Nëse mundeni ju dikush ti ndryshoni këta kufij shkoni në ministri dhe ndoshta i ndryshoni, sepse unë duhet mi zdatu këta kufij Buxhetor. Këto 115.000€ janë prej të hyrave dhe kjo është ajo që mundë të ndahet, që dmth. sa të kemi pare shkojmë e i ndihmojmë kategoritë e caktuara.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Konstatoi Kuorumin, prej 20 anëtarëve prezent në mbledhje.

**\* Kuvendi i Komunës, me 17 vota “Për” me 2 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim” aprovoi Planin Buxhetor Komunal për periudhën 2021-2023, me rekomandimet nga diskutimi publik.**

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Po vazhdojmë e po e kryejmë edhe pikën e pestë e pastaj shkojmë në pauzë.

#### Pika 5

##### Raport Periodik për zbatimin e rekomandimeve nga raporti i ZKA-së

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Kimete Ukaj.

**znj.Kimete Ukaj, zyrtare kryesore financiare;** Ne duhet sipas ligjit që ti raportojmë Kuvendit dy herë në vit. Në vazhdim lexoi raportin në vija të trasha dhe tha se materialin e keni marrë me kohë, kështu që unë i mirëpres pyetjet e juaja, (shih dokumentin).

**z.Rexhep Gashi;** Faleminderit, për prezantimin e kësaj pike. Auditorët kanë gjetur shumë shkelje, te mungesa e dosjeve te personeli, nuk ka të dhëna ku janë marrë punëtorë pa kontrata, kjo është shkelje serioze. Edhe zyrtarja e financave e tha se janë bërë katër shkelje. Te pagat jubilarë, të cilat kanë qenë të garantuara me Kontratën Kolektive, keni qentë të detyruar ti paguani përmes përmbaruesit ku mjetet janë paguar nga investimet kapitale, si kategori jo adekuate, këto pra janë shkelje shumë të rënda. për këtë arsye unë mendoj se këtë raport nuk duhet miratuar.

**z.Naim Zejna;** Auditori i përgjithshëm është autoriteti i pavarur dhe mbi raportin e tij mendojë se nuk kemi qka diskutojmë. Për sa i përket vlerësimit me notën 5 unë edhe atëherë nuk jam pajtuar. Te zjarrfikësit duhet me ndërmarre diçka që bile me mbete në proces. I zbatuar po del vetëm katërshi. Ju duhet me u angazhuar për zbatimin e rekomandimeve të auditorit.

**z.Fehmi Hysenaj;** Faleminderit për raportin, ndërkaq që ju po na sillni informata. Le të na tregon zyrtarja se në bazë të cilit ligj jemi të obliguar për m e sjell në kuvend. Unë mendoj se kjo fare nuk është dashur me ardhur në kuvend.

**z.Ruzhdi Jashari;** E kemi diskutuar raportin e auditorit dhe i kemi dhënë vërejtjet tona. Ky Plan i Veprimit a është shkuar në ministri apo ende jo. Gjysma e rekomandimeve janë të bartura nga viti paraprak, kështu që performanca e komunës është duke ra teposhtë. Barra kryesore është te zyrtari kryesor administrativ e që është Naim Ismajli, ky i nisi procedurat dhe nuk i bitis asnjëherë.

**z.Shefki Dauti;** Unë pajtohem me Fehmiun, që ne e kemi një raport nga auditori i jashtëm rekomandimet e të cilit administrata duhet me i zbatuar. Ne jemi që me kaluar kjo pikë.

**znj.Kimete Ukaj, zyrtare kryesore financiare;** Ju dëgjova me vëmendje. Në faqen e parë e keni të paraqitur bazën ligjore, mbi të cilën jemi të obliguar që kuvendit ti dërgojmë Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm. Sa i përket stafit të zjarrfikësve i ka marrë Ministria e Punëve të Brendshme, por nuk e ka marrë edhe Buxhetin për ta. Ne realisht kemi kërkuar që ta marrin edhe Buxhetin por nuk e kanë marrë.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Konstatoi Kuorumin, prej 20 anëtarëve prezent në mbledhje.

\* Kuvendi i Komunës, me 14 vota “Për” me 1 votë “Kundër” dhe me 5 vota “Abstenim” aprovoi Raportin Periodik për zbatimin e rekomandimeve nga raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit.

**Kryesuesja, znj. Medina Brahaj;** Dha 1 ore pauzë dreke në ora 13h. Do vazhdojmë mbledhjen në ora 14h.

**Kryesuesja, znj. Medina Brahaj;** Vazhdojmë me mbledhjen në ora 14h.

#### Pika 6

##### Informatë nga DKA për përgatitjet e fillimit të Vitit të Ri Shkollor,

**Kryesuesja, znj. Medina Brahaj;** Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Agime Roshaj.

**znj. Agime Roshaj, drejtoreshë e DKA;** Pasi përshëndet të gjithë të pranishmit e prezantoi informatën e përgjithshme për arsimin duke lexuar në pikat kryesore. Ne e kemi përgatitur informatën në formë të shkruar dhe ua kemi dërguar me kohë, kështu që besoj që e keni lexuar dhe unë i mirëpres pyetjet dhe sugjerimet e juaja, (shih dokumentin).

**z. Fehmi Hysenaj;** Faleminderit për informatën. Mendoj se nuk është mirë nga kolegët që në këtë pikë po dalin jashtë. Është mirë që janë përfillur udhëzimet që kanë ardhur nga Ministria e Arsimit dhe janë bërë përgatitjet në shkolla për atë që ka pasur mundësi. Pandemia e ka bërë gjendjen mjaft të vështirë sikur në sektorët tjerë edhe në arsim. Shumë pak në informatë është folur për konkursin e punësimit të mësimit, ku ka marrë pjesë një numër i madh i tyre. Unë realisht kam vërejtje por këtu nuk do të japë. Një gjë tjetër është se për krejt drejtorët është ditë se kush do të pranohet përveç të shkollës profesionale. Rregulloren për bursa duhet ndryshuar sa më shpejtë, sepse kështu në këtë formë ne nuk jemi duke i përkrahur studentët. Numri i testeve për COVID19 është i pamjaftueshëm, po të isha unë mësimit nuk do ta filloja pa u testuar së paku 60%.

**z. Muhamet Ademaj;** Shtatori është muaji për hapjen e shkollave, por sivjet për shkak të pandemisë ka filluar me vonesë më 14 shtatorë. Për, ua është shqetësuese që në disa drejtime nuk po ka staf të mjaftueshëm, sikur është drejtimi i Gjuhës Gjermane. Po ashtu është mirë që të rritet niveli i higjienës nëpër shkolla për shkak të pandemisë.

**znj. Arbresha Sylja;** Faleminderit për raportin. Unë desha ta përgëzoj drejtorin për një fillim të mbarë të procesit mësues, ku shihet se janë bërë përgatitjet e nevojshme qoftë me dezinfektues qoftë edhe me përgatitje teknike. Unë uroj të vazhdojmë me këtë, Skenarin A. E inkurajoj drejtoreshën për punën që është duke bërë.

**znj. Zarife Rexhaj;** Faleminderit për informatën, unë jam që urgjentisht të fillohet procedura për ndryshimin e rregulloreve për ndarjen e bursave, sepse me këtë rregullore po stimulohet sektori privat i arsimit në krahasim me sektorin publik.

**znj. Marigona Pajaziti;** Faleminderit për informatën, lidhur me çështjen e ndryshimit të rregulloreve për ndarjen e bursave për studentë kemi diskutuar edhe në Komitetin për Arsim, dhe kemi ardhë në përfundim se është nevojë e domosdoshme për ndryshimin e kësaj rregullore. Edhe unë jam që të fillojmë me procedurën e ndryshimit. Kam një pyetje për drejtoreshën se a është gati Çerdhja e re për fëmijë? Që nga muaji mars është ndërpre puna mirëpo paret i kanë marrë, pyetja është a ka mundësi të rimbursimit?

**z. Naim Zejna;** faleminderit për informatën. po lidhëm me diskutimin për çerdhen sepse 4 klase janë në shkollën tonë, dhe nëse lëshohet Çerdhja atëherë klasat në shkollën tonë lirohen. Kam një pyetje për drejtoreshën, te Gjimnazi po bashkohen klasat, a nënkupton kjo edhe poshtë?, Pyetja tjetër a keni menduar për zëvendësimin nëse një arsimtar del me COVID19? Çka keni bërë me arsimtarët që janë në moshë të shtyrë dhe me probleme shëndetësore? Mjete dezinfektuese duhet të kemi më shumë, sepse edhe po keqpërdoren. Te matja e temperaturave, tu kisha lutë që me pas termometra më shumë sepse në hyrje të shkollës po krijohen tollovi. A keni ndonjë raport të infektuarve me



virus qoftë nga stafi, qoftë nga nxënësit? Te rregullorja e bursave unë kamë vërejtjet e mia të cilat do ti japë kur të vjen koha.

**z.Rexhep Gashi;** Faleminderit për informatën është për tu përgëzuar fillimi i mbarë i punës në shkolla, dhashtë Zoti që të vazhdojmë, pa raste të infektiveve. Pyetje për drejtoreshën a ka pas ndonjë rast të infektuar, dhe si kanë reaguar prindërit? Sa i përket zgjedhjes së drejtorëve të shkollave, intervista ka qenë veç sa për sy e faqe, sepse është ditë përpara se kush do të jetë drejtor.

**znj.Agime Roshaj, drejtoreshë e DKA;** Sa i përket pranimin të stafit janë procesverbalet që ju mundë ti merrni dhe ti shikoni kur të doni. Nxënësit që vërehen që kanë temperaturë në menjëherë e thirim prindin e tije, ndërkaq që ne e kemi motrën medicinale aty për ti dhënë ndihmën adekuate. Prindërit i kanë respektuar masat dhe nuk kemi as një vërejtje për ta. Nga 14 shtatori nuk kemi të evidentuar as një nxënës përkatësisht as një punëtorë arsimor me simptoma pozitiv. Sa i përket keqpërdorimit të dezinfektuesve ne e kemi deleguar këtë përgjegjësi në shkolla, ku atje ka mundësi të merren edhe masa disiplinore. Ju e dini se ne në Arsim nuk mundemi me organizuar punë me kontratë në vepër, kjo nuk është e lejuar. Jemi të detyruar të bëjmë zgjidhje tjetër nëse na paraqitet ndonjë rast me KOVID19. Po drejtorisë së shkollës i takon me vendosë për sa i përket fuzionimit të orëve, dhe çështjet tjera lidhur me këtë. Sa i përket ndryshimit të rregullores për Bursa është çështje e Kuvendit. Drejtorët e shkollave janë zgjedhur sipas kriterëve dhe në bazë të konkursit. Kuvendi i Komunës i ka pasur antarët e vet në komision, dhe nëse dëshironi unë mund tu a sjell tërë materialin.

**z.Naim Zejna;** propozoj 10min. pauzë për konsultime.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** dha 5min. pauzë konsultative ne ora 15:14h.

Mbledhja vazhdoi në ora 15:23h.

#### Pika 7

#### Shqyrtimi i Kërkesave

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Lexoi kërkesat:

**1. z.Sali Beqa - Petrovë, Kërkesa Nr.01-070/05-6235/20 datë:09.03.2020,** cili nga Kuvendi i Komunës së Shtimes ka kërkuar që të gjej një zgjidhje për pronën në Davidovc me Nr.313/3, 313/4, 313/5 dhe 313/6, me sipërfaqe prej 1 hektar e 2 ari, pasi që nga viti 2007 nuk po mundemi, që ta shfrytëzojmë për shkak të pengesave nga banorët e fshatit Davidovc.

**znj.Adelina Beqaj;** Kjo është një kërkesë e njohur e cila është përsëritur që nga fillimi i mandatit. Unë mendoj që duhet ti japim një zgjidhje, prandaj unë jam që kjo kërkesë me kaluar.

**z.Rexhep Gashi;** Pati të drejtë parafolësja. Unë mund të them se ka qenë një konflikt interesi në mes banorëve të fshatit Davidovc dhe pronarit të tokës. Unë e kam një dokument nga Kryetari i fshatit z.Ilmi Sadriu.

**z.Fehmi Hysenaj;** Kjo kërkesë është në Kuvend që një kohë të gjatë, përkundër që është një vendim i Gjykatës edhe një i Kuvendit. Këtë unë do ta votoj "Për" edhe pse nuk kam ndonjë obligim, por për hir të faktit se është vonuar një përgjigje e jona si dhe për shkak se nuk kemi ndonjë pengesë që mos me mund me ja dhënë. Meqenëse edhe fshati Davidovc e ka pranuar si kompromis. Edhe unë jam me atë pjesë që është pajtuar fshati. Le të vendoset për sipërfaqen që e ka dhe pikë.

**z.Naim Zejna;** Unë kam propozuar që ky rast të kthehet në pikën zero. Unë jam që prona e këtij të zhvendoset në kufi me pronën që ja kemi dhënë në shfrytëzim firmës STN, ashtu si është pajtuar edhe fshati.

**z.Muhamet Ademaj;** Kemi një kërkesë të kamotshme të Sali Beqaj për pronën që i është dhënë në vitin 2007, është mirë që sot ta marrim një vendim, ose që ta aprovojmë kërkesën ose ta hedhim poshtë.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Konstatoi Kuorumin, prej 16 anëtarëve prezent në mbledhje.

\* Kuvendi i Komunës, me 13 vota "Për" me 2 vota "Kundër" dhe me 1 votë "Abstenim" aprovoi Vendimin me të cilin aprovet kërkesa Nr.01-070/05-6235/20 e datës: 09.03.2020, të

**z.Sali Beqaj nga fshati Petrovë, për Zhvendosjen e Pronës së paluajtshme të Ngastrave Kadastrale me numër Nr.313/3, 313/4, 313/5 dhe 313/6, Zona Kadastrale – Davidovc, Kultura: Kullosë e klasës së -I-. Evidentuar pronë e Sali Beqaj – Petrovë, me gjithsej sipërfaqe prej 1 hektar e 2 ari, (10.248m<sup>2</sup>).**

**Duke e zhvendosur me pronën e paluajtshme të Komunës së Shtimes, me sipërfaqen e barabartë në pjesën e Ngastrës Kadastrale Nr.333/4; Zona Kadastrale – Davidovc; Kultura: Kullosë e klasës së -I- ; Evidentuar Pasuri Shoqërore e Kuvendit Komunal – Shtime.**

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Lexoiu kërkesat dhe Rekomandimin e Zyrës së Kryetarit ku i Rekomandon Kuvendit që Kërkesat të shtyhen për mbledhjen e muajit Tetor.**

**2. z.Salami Rashiti - Petrovë, Kërkesa Nr.01-070/05-16704/20 datë:26.08.2020, i cili nga Kuvendi i Komunës së Shtimes ka kërkuar, që ti jap në shfrytëzim pronën Komunale, në ngastrën kadastrale Nr.2270-4, Zona Kadastrale – Shtime, me sipërfaqe prej 50 ari.**

**3. z.Albnor Shehu – Rr.”Xhamia” Nr.5 Doganej – Kaqanik, Kërkesa Nr.01-070/05-18513/20 datë: 16.09.2020, i cili nga Kuvendi i Komunës së Shtimes ka kërkuar, që ti jap në shfrytëzim për 99 vite pronën Komunale, në ngastrën kadastrale Nr.333-3 me sipërfaqe S=45ari 64m<sup>2</sup>, si dhe në ngastrën kadastrale Nr.333-4 me sipërfaqe S=10 ari 20m<sup>2</sup>. Sipërfaqe totale – 00.55.84m<sup>2</sup>. Në Zonën Kadastrale Davidovc.**

**z.Fehmi Hysenaj; Unë mendoj se këto dy kërkesa duhet të hiqen nga shqyrtimi sepse në bazë të Ligjit po shihet haptazi se për kënd ne po i shpallim këto prona me interes të përgjithshëm.**

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Ne këto prona duhet ti shpallim me interes të përgjithshëm, por pa përmendur emra të atyre që kanë bërë kërkesa.**

**z.Fehmi Hysenaj; Edhe unë propozoj që këto prona të shpallen me interes të përgjithshëm.**

**znj.Arbresha Sylja; Kryesuesja, e sqaroi se çka ka thënë MAPL-ja, ndërkaq që tani ne mund të vendosim. DPUKGJ-ja na ka ofruar orto-foto që objekti nuk ekziston në teren, mirëpo unë po kërkoj që të na ofrojnë orto-foto të tjera. Kërkesat pak e shumë janë të njëjta që kanë kërkuar pronë komunale në shfrytëzim.**

**z.Reshat Mujota; Plotësisht pajtohem me sqarimin që e dha zyrtari i Kuvendit. Kemi procesverbale ku shihet se kemi dhënë prona në shfrytëzim personave të njëjtë që kanë bërë kërkesa. Unë mendoj se pronat duhet të shpallen me interes të përgjithshëm por nuk duhet të ketë asnjë lidhje me parashtruesit e kërkesave.**

**z.Naim Zejna; Unë po kërkoj që ta kemi një interpretim Ligjor sepse e kemi Zyrtarin Ligjor, dhe në fund e kemi edhe Zyrën Ligjore të MAPL-së.**

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Përveç këtyre kemi edhe kërkesat me përmbajtje të njëjtë siç janë:**

**4. z.Eqrem Krasniqi - Dugë, Kërkesa Nr.01-070/05-14205/20 datë: 06.08.2020, i cili nga Kuvendi i Komunës së Shtimes ka kërkuar, që ti jap në shfrytëzim pronën Komunale, në ngastrën kadastrale Nr.230-0 me sipërfaqe S=XXm<sup>2</sup>, si dhe në ngastrën kadastrale Nr.251-0 me sipërfaqe S=XXm<sup>2</sup>. Në Zonën Kadastrale Dugë.**

**5. z.Bekim Shashivari, Rr. “Dëshmorët e Reqakut” – Shtime, Kërkesa Nr.01-070/05-18848/20 datë: 21.09.2020, i cili nga Kuvendi i Komunës së Shtimes ka kërkuar, që ti jap në shfrytëzim për 99 vite pronën Komunale, në ngastrën kadastrale Nr.333-4 me sipërfaqe 1 Hektarë. Në Zonën Kadastrale Davidovc.**

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 16 anëtarëve prezent në mbledhje.**

**\* Kuvendi i Komunës, me 14 vota “Për” me 1 votë “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim” vendosi që Kërkesat sipas Listës së Kërkesave Npi-01/194, me numër: 2,3,4 dhe 5 të trajtohen në Pako.**

\* Kuvendi i Komunës, me 14 vota “Për” me 1 votë “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim” vendosi që të aprovoi Vendimin për aprovim paraprak me interes të përgjithshëm për biznese, pronat Komunale si vijon:

1. Ngastra Kadastrale: Nr. P-72809029-00230-0; Me sipërfaqe 35231m<sup>2</sup>; Z. K. – Dugë;
  2. Ngastra Kadastrale: Nr. P-72809029-00251-0; Me sipërfaqe 3859m<sup>2</sup>; Z. K – Dugë;
  3. Ngastra Kadastrale: Nr. P-72809093-02270-4; Me sipërfaqe 33220m<sup>2</sup>; Z. K – Shtime;
  4. Ngastra Kadastrale: Nr. P-72809023-00333-3, me sipërfaqe prej: 8000m<sup>2</sup>, Z.K-Davidovc.
  5. Ngastra Kadastrale: Nr. P-72809023-00333-4, me sipërfaqe prej: 21986m<sup>2</sup>, Z.K-Davidovc.
- Ndërsa Kërkesat sipas Listës së Kërkesave Npi-01/194, me numër: 2,3,4 dhe 5 refuzohen.

**z.Fehmi Hysenaj;** Ka kërkuar që të evidentohet në Procesverbal, se ka votuar “Kundër”

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Propozoj që të formojmë edhe Komisionin Vlerësues.

**z.Reshat Mujota;** Unë mendoj se Komisioni duhet të mbetet për me u zgjedhë për mbledhjen e radhës.


**z.Herolind Selmani;** Unë e propozoj Diarta Vishesella për anëtare të Komisionit Vlerësues.

**znj.Adelina Beqaj;** Edhe unë mendoj se në mbledhjen e radhës është më mirë të vendosim për Komisionin Vlerësues sepse atëherë do ta kemi edhe emrin e anëtarëve nga ekzekutivi si dhe nga OJQ-të.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Mirë atëherë po e lëmë për mbledhjen e radhës formimin e Komisionit Vlerësues.

Pasi që diskutime tjera nuk kishte Kryesuesja mbledhjen e përfundoi në ora 16.<sup>10</sup>h.

Procesmbajtësi:  
Idajet Rexhepi



Kryesuesja e Kuvendit  
Medina Brahaj

